

STATUT
I SHOQERISE AKSIONERE
SISTEMI ME NJE NIVEL
“ IMPERIAL GROUP “ SHA

KREU I

Sot ne date 30 Korrik 2024, ne respektim të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, ligjit 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, me cilësinë e ortakeve themelues të shoqërisë:

Z.Pellumb Gjoka (përfaqësuar me prokurë nga znj.Alida Gjoka), i biri i Kole dhe Prene lindur ne Shkoder e datëlindjes 08.04.1974 dhe banues në Tirane, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike për të vepruar, i identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit të mbajtur prej tij me numër Personal H40408126Q.

Z.Kolë Gjoka, i biri i Fran dhe Mrike lindur ne Mali Kolaj, Shkoder e datelindjes 05.04.1943 dhe banues ne Shkoder, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike për të vepruar, i identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit të mbajtur prej tij me numër Personal E30405106G.

Znj.Alida Gjoka, i bija e Ndue dhe Lene lindur ne Pjetroschan, Shkoder e datelindjes 28.05.1982 dhe banues ne Tirane, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike për të vepruar, i identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit të mbajtur prej tij me numër Personal I25528058V.


hartojne këtë statut të shoqërisë aksionere, me emërtimin “Imperial Group” sha:

Neni 1

Emërtimi

Sot, me date 30 Korrik 2024, ne, themeluesit, kemi krijuar nje shoqeri aksionere me emrin **“Imperial Group” sha**, me zyre qendrore e shoqërisë në Shqipëri me adrese Njesia Bashkiake Nr.2, Rruga Luigj Gurakuqi, Pallati Mig-Mar, Pallati 12 katesh , Kati 1, Nr.Pasurie 2/144-N2, Tirane.

Themeluesit e shoqerise jane:



- Pellumb Gjoka
- Kolë Gjoka
- Alida Gjoka

Shoqëria emërtohet “**Imperial Group**” sha. Ajo është person juridik i të drejtës shqiptare, shoqëri aksionere (e cila këtu e më poshtë do të quhet “Shoqëria”).

Neni 2

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetet në këto fusha:

Kryerja e veprimtarisë tregtare në fushën e lojrave të fatit. Importimi, eksportimi i mallrave. Hoteleri, turizëm e shërbime të tjera. Veprimtari në fushën e ndërtimit të objekteve civile industriale-turistike bujqësore mbi 5 kate. Rikonstruksione e 2 Ndërtim banesa me skelet mbi 8 kate. Ndërtim rrugë, ura dhe vepra arti deri në 10m; Ndërtim ujesjelles-kanalizime; Kanale impiante vaditje-kullimi.- Shërbime kembimi valutë brenda ambienteve të Kazinose, në përputhje me dispozitat ligjore rregullatore të detyrueshme në fuqi. Trajnimi i stafit të ri apo ekzistues të Kazinose për qëllime të aktivitetit të Kazinose me synimin e punësimit të një stafi të kualifikuar. Shërbime restoranti dhe bar brenda ambienteve të Kazinose. Importeksport i makinave të lojrave të fatit marrje dhe dhenie me qira e tyre, import-eksport të pajisjeve dhe të materialeve lidhur me kazinotë dhe lojrat e fatit .Prodhim dhe operim i software për lojërë fati. Operim dhe menaxhim i sallave të lojërave të fatit, projektim, menaxhim operim, ndërtim i kazinove. Cdo aktivitet tjetër lidhur me kazinotë dhe me lojrat e fatit në përputhje të plote me legjislationin e zbatueshëm Shqiptar.

Neni 3

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.



Neni 4

Selia

Shoqëria e ka selinë kryesore ne adresën: Njesia Bashkiake Nr.2, Rruga Luigj Gurakuqi, Pallati Mig-Mar, Pallati 12 katesh , Kati 1, Nr.Pasurie 2/144-N2. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale brenda edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakeve.

KREU II

KAPITALI

Neni 5

Kapitali themeltar


Kapital i regjistruar i shoqerise eshte **1,422,527,659 leke**, i ndare ne aksione te zakonshme me vlere nominale **372,682.12 leke** secili.

Numri i pergjithshem i aksioneve eshte **3817** aksione.

Vlera e kapitalit të shlyer **1,422,527,659 leke**.

Aksionet e themeluesve ne kapitalin e shoqerise jane ne perputhje me kontributin e tyre te meposhtem:

1. Aksionari themelues Pellumb Gjoka; lloji i kontributit ne para **307,328,000 leke** dhe ne natyre **489,287,489.04 leke**; numri i aksioneve me te drejte vote 2137, perqindja e pjesemarrjes 56%, vlere e kontributit ne total **796,615,489.04 leke**.
2. Aksionari themelues Kole Gjoka; lloji i kontributit ne para **120,736,000 leke** dhe ne natyre **192,220,084.98 leke**; numri i aksioneve me te drejte vote 840, perqindja e pjesemarrjes 22%, vlere e kontributit ne total **312,956,084.98 leke**.



3. Aksionari themelues Alida Gjoka; lloji i kontributit ne para **120,736,000 leke** dhe ne natyre **192,220,084.98 leke**; numri i aksioneve me te drejte vote 840, perqindja e pjesemarrjes 22%, vlere e kontributit ne total **312,956,084.98 leke**.

Neni 6

Kerkesa per te paguar aksionet

- 1- Administratori mund t'u kerkoje aksionereve pagimin e kontributeve te pashlyera ne lidhje me aksionet e tyre dhe cdo aksionar. Njoftimi per pagese mund te parashikoje shlyerjen me keste te kontributeve te papaguara. Personi te cilit i drejtohet njoftimi per pagesen e kontributit do te jete pergjegjes per njoftimet qe i drejtohen atij pavarsisht kalimit te mepasshem te pronesise se aksioneve me te cilat lidhet njoftimi per pagese.
- 2- Zoteruesit e perbashket te nje aksioni do te jene pergjegjes bashkerisht dhe ne menyre solidare per shlyerjen e kontributeteve, sipas njoftimit te mesiperm.

Neni 7

Llojet dhe kategorite e aksioneve

Aksionet mund te jene te zakonshme ose aksione me perparesi. Aksionet e zakonshme u japin zoteruesve te tyre tager per te ushtruar ne asamblene e pergjithshme te drejtat e aksionarit dhe per te perfituar pjese te fitimeve dhe te shperndarjes e pasurive te mbetura pas likuidimit, ne raport me pjesen e kapitalit qe aksionet e tyre perfaqesojne. Aksionet me perparesi u japin zoteruesve te tyre tagrin qe nga ndarja e dividenteve te vendosur nga asambleja te perfitojne nje shume te caktuar ose nje perqindje te caktuar te vleres nominale te aksioneve te tyre, perpara shperndarjes se fitimeve, ne favor te aksionareve te zakonshem, perparesi ne ndarjen e pasurive te shoqerise, te mbetura pas likuidimit dhe te drejta te tjera te percaktuara me ligj ose statut. Aksionet qe japin te njejtat te drejta, perbejne aksione te se njejtës kategori.



Neni 8

Regjistri i aksioneve

Shoqeria aksionere mbaj nje regjister te posacem, ku regjistrohen te dhenat e zoteruesve te aksioneve te shoqerise.

Administratori eshte pergjegjes per mbajtjen e regjistrit e detyrohet te lejoje aksesin ne informacionet e regjistrit ndaj cdo aksionari apo cdo personi tjetër qe e kerkon. Informacioni i regjistrit te aksioneve duhet te publikohet ne faqen e shoqerise ne internet. Shoqeria mund te lejoje regjistrimin on-line te te dhenave, qe duhen regjistruar sipas pikes 1 te ketij neni.

Administratori i ngarkuar me detyren e mbajtjes se regjistrit te aksioneve eshte **Gentjan Haka**.

Neni 9

Menyrat e fitimit de kalimit te Aksioneve

Aksionet e shoqerise aksionere e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë, ne castin e formimit te shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Aksionet e te drejtat e fituara si me siper nuk mund te ushtrohen ndaj asnje personi apo ndaj shoqerise, perpara se veprimi te jete regjistruar ne regjistrin e posacem te aksioneve, qe mban shoqeria, ne perputhje me piken 1 te nenit 119 te Ligjit 9901.



Neni 10

Zmadhimi i Kapitali Themeltar

1. Kapitali i regjistruar i shoqerise mund te zmadhohet duke emetuar aksione rishtazi, kundrejt kontributeve te reja. Kur emetohen aksione te reja, keto aksione iu ofrohen aksionareve ekzistues perpara se t'u ofrohen aksionareve te tjere te rinj, ne pajtim me nenin 174 te Ligjit. Aksionet e reja iu ofrohen aksionareve sipas numrit te aksioneve qe zoterojne perpara ofertes. Oferta qe iu behet aksionareve ekzistues duhet te pranohet brenda 20 ditesh pas publikimit ne QKR.
2. Asambleja e pergjithshme mund te vendose qe zmadhimi i kapitalit te kryhet me emetim te aksioneve te reja, per t'u nenshkruar vetem nga aksionaret ekzistues. Zmadhimi i kufizuar i kapitalit mund te kryhet vetem me miratimin unanim te te gjithe aksionareve.
3. Zmadhimi i kapitalit me aktivet e shoqerise. Pas miratimit te bilancit te vitit paraardhes, asambleja e pergjithshme mund te vendose ta zmadhoje kapitalin e regjistruar, duke kaluar ne kapitalin baze reervat e disponueshme dhe fitimet e pashperndara.

Neni 11


Zvogelimi i Kapitali Themeltar

Kapitali i regjistruar i shoqerise mund te zvogelohet me vendim te asamblese se pergjithshme, ne perputhje me percaktimet e pikes 1 te nenit 145 te ligjit 9901.

Nese zvogelimi ndryshon te drejtat e nje kategorie te caktuar aksionesh, vlefshmeria e tij kushtezohet nga pelqimi i aksionareve perkates, i cili duhet te permbushe kerkesat formale te pikes 3 te nenit 149 te ketij ligji.

Zvogelimi i kapitalit realizohet nepermjet zvogelimit te vleres nominale te aksioneve dhe anulim aksionesh.

Kapitali i regjistruar mund te zvogelohet nen vlerat nominale te parashikuara ne ligj, vetem ne rastin kur zvogelimi shoqerohet me nje zmadhim te njekohshem te kapitalit.



KREU III

Organet e Shoqerise

Neni 12

Organet e Shoqerise


Organet e shoqerise jane:

1. Asambleja e Pergjithshme;
2. Keshilli i Administrimit;
3. Aministratori/administratores

Neni 13

Asambleja e Pergjithshme

1. Asambleja e pergjithshme merr vendime per çështjet e meposhtme te shoqerise:
 - a. përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b. ndryshime te statutit;
 - c. emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - d. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e. miratimin e skemes se shpërblimeve;
 - f. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - g. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - h. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i. shpërndarjen e fitimeve vjetore;
 - j. zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar;
 - k. pjesetimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
 - l. ndryshime ne te drejtat qe lidhen me aksione te llojeve e kategorive te vecanta;
 - m. perfaqesimin e shoqerise ne gjykimet ndaj organeve te administrimit;
 - n. riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
 - o. miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te saj;



- p. ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti;
2. Asambleja merr vendime pas shqyrtimit te dokumebteve perkatese, se bashku me raportin e keshillit te administrimit dhe raportin e ekspertit kontabel te autorizuar.
 3. Nese shoqeria zoterohet nga nje aksionar, te drejtat dhe detyrimet ushtrohen nga aksionari i vetem. Te gjitha vendimet regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar ne vecanti vendimet e meposhtme:
 - a. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - b. shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;
 - c. zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar;
 - d. vendimet per investime;
 - e. riorganizimi dhe prishja e shoqerise;

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.


Neni 14

Thirrja e Asamblese se Pergjithshme

Asambleja thirret nga Administratori dhe nga Anetaret e Keshillit te Administrimit apo nga aksioneret e percaktuar sipas nenit 139 te Ligjit 9901.

Asambleja thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose nepermjet postes elektronike.

Njoftimi me shkrese apo mesazh dhe rendi i dites u derghen te gjithe aksionareve, jo me vone se 21 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e Asamblese.



Neni 15

Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme

Asambleja merre vendime te vlefshme vetem me arritjen e kuorimit te parashikuara nga neni 144 i Ligjit. Gjate mbledhjes se asamblese pergatitet lista e aksionereve te pranishem dhe te perfaqesuesve te tyre ku shenohen emrat dhe adresat e secilit, se bashku me numrat e aksioneve, numrin e votave, qe keto aksione japin, vleren nominale, llojin dhe kategorine e tyre, te zoteruara nga secili pjesemarrës. Kjo liste u vihet ne dispozicion aksionereve dhe perfaqesuesve te tyre dhe nenshkruhet prej tyre.

Asambleja cakton nje kryetar. Nese asnje prej Administratoreve nuk deshiron te caktohet si Kryetar i mbledhjes ose ndonjeri prej tyre nuk eshte i pranishem per pesembedhjete minuta duke filluar nga ora e caktuar per fillimin e mbledhjes, aksionaret e pranishem zgjedhin njerin prej tyre si Kryetar te mbledhjes. Administratori ose anetari i Keshillit te Administrimit ka te drejten e pjesemarrjes dhe marrjen e fjales ne cdo mbledhje.

Neni 16

Kuorumi

Ne rastin e ceshtjeve qe vendosen me shumive te zakonshme, asambleja mund te marre vendime te vlefshme, vetem nese jane te pranishem ose te perfaqesuar aksionaret, qe zoterojne me shume se 30% te aksioneve. Kur asambleja duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, sipas nenin 45 te Ligjit 9901, asambleja mund te marre vendime te vlefshme, vetem nese aksionaret, qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te aksioneve me te drejte vote marrin pjese ne votim personalisht ose votojne me shkrese apo me mjete elektronike sipas nenit 142 te ketij Ligji.

Nese Asambleja nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuoromit, ajo mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njehtin rend dite.



Neni 17

Marrja e Vendimeve

Asambleja vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitali te aksionereve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Neni 18

Keshilli i Administrimit

1. Asambleja cakton tre ose me shume, por jo me shume se 21, persona fizike si anetare te Keshillit, ne pajtim me nenin 135 dhe nenin 155 te ketij Ligji. Emertimet fo te jene individuale ose ne perputhje me vendimin e mbledhjes se Asamblese te marre ne shumice votash, i cili miratohet, sjell emerimin e personit te propozuar si anetar. Anetaret e Keshillit mund te shkarkohen nga detyrane cdo kohe nga Asambleja, pa cenuar te drejtat qe burojne nga nje kontrate pune e lidhur me Shoqerine.
2. Shumica e anetareve do te jene te pavarur dhe nuk do te jene Administratore, ne perputhje me parashikimet e pikes 1 dhe 4 te nenit 155 te Ligjit.
3. Anetaret mund te caktojne nje person i cili deshiron te veproje ne cilesine e anetarit, duke pasur parasysh se emerimi nuk perben zmadhim te numrit te anetareve, te permendur ne piken 1 te ketij neni. Anetari i emeruar ne kete menyre do te jete ne detyre deri ne mbledhjen vjetore vijuese te Asamblese.
4. Personat e meposhtem emerohen si anetare te pare te Keshillit te Administrimit te Shoqerise deri ne zgjedhjen e tyre nga mbledhja e pare e Asamblese sipas shkronjes "c" pika 2 te nenit 135 te Ligjit.




Personat e mëposhtem emërohen si anëtarë deri në zgjedhjen e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë:

- Pellumb Gjoka
- Gentjan Haka
- Edmond Preka

Neni 19

Kompetencat e Keshillit të Administrimit dhe Komiteteve të tij

- 1- Keshilli i Administrimit udhëzon Administratorët në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe kontrollon përputhshmërinë e tyre me ligjin dhe Statutin. Detyrat e mbikeqyrjes së Keshillit të Administrimit sipas shkronjave b,c,d,dh,e,f,g,i të pikës 1 dhe pikës 2 të nenit 154 të Ligjit, nuk mund t'i u delegohen Administratorëve.
- 2- Anëtarët mund t'i delegojnë kompetencat e tyre çdo komiteti i cili përbehet nga një ose më shumë anëtarë. Delegimi i këtyre kompetencave mund të kryhen në përputhje me kushtet e vendosura nga anëtarët dhe këto kompetenca mund të revokohen ose ndryshohen.
- 3- Për sa më lart Keshilli do të krijojë:
 - një komitet, i cili përcakton standartet për emërimin e Administratorëve.
 - një komitet, i cili përcakton skemën e shpërblimit dhe atë individual të administratorëve dhe anëtarëve të Keshillit.
 - një komitet për kontrollin e mbarevajtjes dhe kontabilitetit të shoqërisë.
- 4- Komitetet e emërimit, shpërblimit dhe kontrollit japin rekomandime të cilat synojnë përgatitjen e vendimeve që duhen marrë. Qëllimi kryesor është rritja e efikasitetit duke u kujdesur që vendimet të merren në mënyrën e duhur. Krijimi i tyre nuk zhvendos çështjet e marra në shqyrtim nga Keshilli i cili mbetet organi përgjegjës për vendimet e marra në fushën e tij të kompetencës.
- 5- Në vecanti komiteti i kontrollit financiar:
 - mbikeqyr procesin e raportimit financiar;
 - mbikeqyr efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe të administrimit të rreziqeve;
 - mbikeqyr kontrollin e bilanceve vjetore;
 - shqyrton pavarësinë e ekspertëve kontabel të autorizuar;
- 6- Ndryshimet e statutit dhe udhëzimeve të Asamblesë nuk do të shfuqizojnë aktet e mëparshme të Keshillit, të cilat do ishin të vlefshme nëse ndryshimi nuk do të ishte kryer ose udhëzimi nuk do



te ishte dhene.

Neni 20

Mbledhjet e Keshillit te Administrimit

- 1- Mbledhjet e Keshillit do te mbahen te pakten 2 here ne vit sipas nevojave te aktivitetin tregtar te Shoqerise, derisa Asambleja te vendose me shumice votash mbi shpeshesine e mbledhjeve te Keshillit te Administrimit.
- 2- Vendimet merrem me kuorimin e percaktuar ne nenin 162 te Ligjit. Anetaret mund te marrin pjese ne mbledhje nepermjet mjeteve elektronike.
- 3- Anetaret emerohje njerin prej tyre si Kryetar te mbledhjes i cili mund te shkarkohet ne cdo kohe nga kjo detyre. Administratori nuk mund te emerohet si Kryetar i Keshillit.
- 4- Ceshtjet e rendit te dites vendosen me shumice te votave te pjesemarresve. Ne rast barazimi votash, vota e Kryetarit do te jete vendimtare.
- 5- Te gjitha aktet e kryera nga mbledhja e Keshillit, ose komitetet e anetareve, ose nga persona te tjere te cilet veprojne si anetare te Keshillit te Administrimit do te konsiderohen te vlefshme njelloj sikur keta te ishin emeruar rregullisht.
- 6- Vendimi me shkrim i nenshkruar nga te gjithe anetaret e Keshillit te Administrimit qe kane te drejte te njoftohen per mbledhjen e Keshillit do te konsiderohet i vlefshem dhe i efektshem njelloj si te ishte i miratuar ne mbledhjen e Keshillit ose ne komitetit e anetareve te Keshillit te thirrur dhe mbledhur rregullisht.

Neni 21

Procesverbali i Mbledhjes se anetareve te Keshillit te Administrimit

Anetaret e Keshillit te Administrimit do te mundesojne mbajtjen e procesverbaleve te mbledhjeve ne libra te posacem per:

- 1- Te gjitha emerimet e kryera nga anetaret e Keshillit te Administrimit;
- 2- Te gjitha mbledhjet e Asamblese, mbledhjet e zoteruesve se aksioneve te klasave te ndryshme dhe mbledhjet e Keshillit dhe komiteteve, perfshire dhe emrat e anetareve te Administrimit te



pranishem ne keto mbledhje.

Neni 22


Shkarkimi i anetareve te Keshillit te Administrimit

- 1- Detyra e anetarit te Keshillit perfundon ne rast se:
 - personi nuk eshte me anetar ne baze te dispozitave te Ligjit perfshire nenin 157 dhe piken 7 te nenit 18;
 - personi ndodhet ne gjendje paaftesie pagueese;
 - vuan nga crregullime mendore;
 - kur jep doreheqjen duke njoftuar shoqerine;
 - ka munguar per me shume se 6 muaj pa lejen e anetareve ne mbledhjet e mbajtura;

Neni 23

Administratoret

- 1- Keshilli zgjedh nje apo me shume persona fizike si Administratore dhe perfaqesues te shoqerise per nje periudhe 3-vjecare, ne pajtim me nenin 158 te Ligjit. Emertimet do te jene individuale dhe sipas nje vendimi te Keshillit, i cili, nese miratohet sjell emerimin e personit te prpozuar si Administrator. Mund te shkarkohen ne cdo kohe pa cenuar te drejtat qe burojne nga nje kontrate pune e lidhur me shoqerine.
- 2- Anetaret e Keshillit mund te caktohen si Administratore per sa kohe shumica e anetareve perbehet nga persona te pavarur qe nuk ushtrojne kompetenca administrimi.
- 3- Z.Gentjan Haka caktohet si administratore i pare deri ne emerimin e tij nga mbledhja e pare e Keshillit.
- 4- Politikat tregtare do te administrohen dhe shoqeria do te perfaqesohet nga Administratori.
- 5- Ndryshimet e statutit nga Asambleja dhe udhezimeve te Keshillit nuk do te shfuqizojne akte te meparshme, te cilat do ishin te vlefshme nese ndryshimi nuk do te ishte kryer.



Neni 24

Shkarkimi i Administratoreve

Detyra perfundon nese:

- 1- Nuk eshte me administrator ne baze te dispozitave te Ligjit perfshire shkarkimin nga Asambleja ne pajtim te pikes 2 te nenit 167 dhe shkronjes c te pikes 2 te nenit 135 te Ligjit;
- 2- Personi ndodhet ne gjendje paaftesie paguese;
- 3- Personi jep doreheqjen nga detyra duket njoftuar shoqerine;
- 4- Ka munguar per me shume se 6 muaj pa miratimin e anetareve te Keshillit;


KREU IV

Dividentet dhe Kalimi i Fitimeve ne kapitalin Themeltar

Neni 25

Dividentet

- 1- Ne perputhje me dispozitat e Ligjit shoqeria me shumice te zakonshme te vottave te Asamblese mund te deklaroje dividentet ne perputje me te drejtat perkatese te aksionereve.
- 2- Me perjashtim te rasteve kur parashikohet nga te drejtat qe lidhen me aksionet, te gjithe dividentet deklarohen dhe paguhen ne perputhje me shumet e paguara per aksionet per te cilat paguhet dividenti. Te gjithe dividentet paguhen dhe pjestohenne perpjestim te drejte me shumet e paguara te askioneve, pjeses ose pjeseve te periudhes per te cilat pagueht dividenti; ne rast se aksioni emetohet me kushtin e perfitimit te dividentit nga nje date e caktuar, dividenti do te paguhet ne perputhje me kete kusht.
- 3- Asnje divident nuk prodhon interesa kundrejt shoqerise nese dicka e tille nuk parashikohet ne te drejtat e aksionit.
- 4- Cdo divident qe nuk eshte kerkuar te pagueht brenda 12 viteve nga data e maturimit, ne rast se vendoset nga Asambleja , do te perfitohet nga shoqeria e cila nuk do te jete me e detyruar qe ta



paguaje ate.

Neni 26

Kalimi i Fitimeve ne Kapitalin Themeltar

Administratoret, pas vendimit te marre nga Asambleja me shumice te kualifikuar votash sipas kuorimit te percaktuar nga neni 145 i Ligjit, mund te vendose te kaloje ne kapitalit themeltar te shoqerise fitimet e pashperndara te cilat nuk do te perdoren per te paguar dividende preferenciale apo shuma te tjera te parashikuara per rezerva ligjore ose kapitali.

KREU V

Prishja dhe likuidimi

Neni 27

Prishja dhe likuidimi

Ne rast te likuidimit te Shoqerise, likuiduesi, ne perputhje me Ligjin dhe me vendimin e posacem te Asamblese, te marre me shumice te kualifikuar mund te shperndaje ne dobi te aksionereve te gjithë ose nje pjese te vleres te pasurive te Shoqerise dhe per kete qellim mund te vleresoje cdo pasuri dhe te percaktoje menyren e shperndarjes midis askionereve.

Neni 28

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe



shoqerite tregtare”, Kodit Civil dhe cdo ligji specifik ne Shqiperi.

Neni 29

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

AKSIONERËVE THEMELUES TË SHOQËRISË “IMPERIAL GROUP” SHA

ORTAKËT E SHOQËRISË

Pellumb Gjoka

(përfaqësuar me prokurë nga znj. Alida Gjoka)

Alida Gjoka



Alida Gjoka

Alida Gjoka



Kolë Gjoka

